



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZH D

KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I ARSIMIT, KULTURES, SPORTIT, SHENDETESISË DHE ÇESHTJEVE
SOCIALE

RAPORT VENDIMARRJE

Nr.1, Datë/6 /12/ 2024

Lënda: Vendim për shqyrtimin e projekt-vendimit nr. datë, 12/ 2024 “Plani i Përmirësimit të Shërbimit të Arsimit Parashkollor”

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Librazhd

Ky projekt-vendim paraqitet nga Agjensia e Funksionimit të Patransferueshem, Sektori i Arsimit, Kultures, Rinise, Sporteve dhe Organizimit të Aktiviteteve Festive, dhe ka për qëllim:

Bazushmeria Ligjore dhe Votimi	Ligji 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” datë 17.12.2015, i ndryshuar, Rregullores së Pergjithshme të Këshillit Bashkiak dhe Rregullores së Konsultimit Publik. Ky projekt-vendim bazohet në nenin 54 të ligjit 139/2015, pika “k”. Votimi që kërkohet është me shumicë thjeshte me 50+1
Situata Aktuale e Funksioit	<p>Në vitin 2015, gjatë periudhës së ndryshimeve politike në Shqipëri, u ndërmorën reforma të rëndësishme që preknin strukturën e Bashkive në vend. Këto ndryshime organizative sollën krijimin e 61 Bashkive të reja, duke sjellë me vete sfida të shumta administrative dhe organizative. Këto transformime u realizuan në përpjekje për të decentralizuar më tej pushtetin vendor dhe për të përgjigjur më mirë nevojave për zhvillim dhe mirëqënie sociale dhe ekonomike në nivel lokal.</p> <p>Në lidhje me arsimin parashkollor, Bashkia Librazhd mori përsipër përgjegjësinë për zbatimin dhe përmirësimin e këtij shërbimi në territorin e saj. Pas një eksperience pune nëntë vjeçare në ofrimin e shërbimit të Arsimit Parashkollor, tashmë duke njohur mirë nevojat dhe sfidat, Bashkia Librazhd ka punuar ngushtesisht me Projektin Bashki të Forta për një plan të qartë afatmesëm për përmirësimin në vijim të shërbimit për të adresuar nevojat dhe sfidat në kopshte.</p> <p><u>Qëllimi</u> i planit është të përmirësojë cilësinë e arsimit parashkollor në Bashkinë Librazhd, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none">-përmirësimi i shërbimit në kopshtet ku mungojnë regjistrimet në mënyrë që të rriten regjistrimet;-planifikim strategjik përsa i përket riorganizimit të infrastrukturës së kopshtit, me qëllim përmirësimin e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHID
KESHILLI BASHKIAK
KOMISIONI I ARSIMIT, KULRURES, SPORTIT, SHENDETESISE DHE ÇESHTJEVE
SOCIALE

shërbimit në kopshtet që janë brenda shkollave, ose kopshteve që kanë nevojë imediate për restaurim;

- zhvillimi i burimeve njerëzore të bashkisë në çështje të arsimit parashkollor, përmes ndërgjegjësimit në të gjitha nivelet e drejtimit dhe administratës së bashkisë për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të përmirësimit;

- ngritja e një databaze efektive për menaxhimin e strukturave të Arsimit Parashkollor, sipas së cilës sigurohet respektimi i kërkesave ligjore dhe kuadrit të brendshëm rregullator nga zyrtarët vendorë (autoritetet dhe administrata) si edhe përmirësimin dhe forcimin e këtij kuadri për të parandaluar dhe eliminuar shkeljet;

- bashkëpunimi i ngushtë me prindërit dhe komunitetin, për të ndërgjegjësuar për rëndësinë që ka kopshti në zhvillimin e fëmijës; përmirësimin e infrastrukturës së kopshteve, zhvillimin e burimeve njerëzore dhe krijimin e një databaze efektive për menaxhimin e strukturave të arsimit parashkollor.

Plani synon të harmonizojë aktivitetet në një vizion të përbashkët dhe koherent, duke përfshirë bashkëpunimin me prindërit dhe komunitetin.

Plani i Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor përqendrohet në Proceset e Menaxhimit të shërbimit në arsimin parashkollor, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe organizimit efektiv.

Planifikimi dhe kontrolli i cilësisë janë thelbësore për këtë qëllim, duke përfshirë planifikimin e numrit të fëmijëve në kopshte dhe vlerësimin e infrastrukturës së nevojshme. Objektivat kryesore të planit përfshijnë:

- përmirësimi i ofrimit të shërbimit në kopshte nëpërmjet organizimit të regjistrimeve sipas vendbanimeve;
- përmirësimi i infrastrukturës së kopshteve;
- ulja e numrit të grupeve të përziera në kopshte nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës;
- ngritja dhe fuqizimi i strukturave mbështetëse të kopshtit (Bordi dhe Këshilli i Prindërve), Komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit;
- përmirësimi i procesit të identifikimit dhe shërbimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, me aftësi të kufizuar dhe në nevojë për përfshirje sociale

Në një periudhë tre vjeçare, Plani prezanton sfidat dhe mundësitë specifike të regjistrimit të fëmijëve, duke



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD

KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I ARSIMIT, KULRURES, SPORTIT, SHENDETESISE DHE ÇESHTJEVE
SOCIALE

përfshirë nevojën për të identifikuar nevojat e komunitetit dhe për të përdorur teknologjinë për të përmirësuar menaxhimin e të dhënave. Lista e aktiviteteve përfshin projekte si punësimi i specialistëve për arsimin parashkollor, vlerësimin e brendshëm kopshteve, themelinin dhe funksionalizimin e organizmave të institucionit arsimor si Bordi i Kopshtit, Këshilli i Prindërve, Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, si dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta me komunitetin dhe prindërit për të përmirësuar shërbimin.

Plani i Përmirësimit të Shërbimit synon të adresojë proceset kryesore dhe të përmirësojë shërbimin për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale, mbrojtje dhe ata me aftësi të kufizuara në kopshtet publike të Bashkisë Librazhd. Qëllimi kryesor është të rritet identifikimi, vlerësimi dhe trajtimi më i mirë i këtyre rasteve në mënyrë që të sigurohet një shërbim cilësor dhe i plotë për fëmijët në nevojë.

Për të arritur këtë qëllim, plani ka disa objektiva të përgjithshëm, si rritja e identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, mbrojtje dhe me aftësi të kufizuara, si dhe përmirësimi i procesit të menaxhimit të këtyre rasteve. Në mënyrë specifike, për të adresuar nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, plani synon të përmirësojë procesin e diagnostikimit të tyre dhe të sigurojë infrastrukturë të përshtatshme në kopshte për t'i bërë ata të aksesueshëm.

Në të njëjtën kohë, plani përfshin ndihmë të përditshme për të gjithë fëmijët në nevojë, përfshirë mbështetje ushqimore, trajtim psikologjik, si dhe ndërhyrje ligjore në rastet e nevojshme. Përveç kësaj, synohet edhe hartimi dhe zbatimi i politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucionet arsimore dhe përmirësimi i bashkëpunimit mes strukturave të shërbimit social të përfshira për të garantuar një trajtim të drejtë dhe të efektshëm për të gjithë fëmijët në nevojë.

Planifikimi dhe zbatimi i proceseve mbështetëse në Planin e Përmirësimit të Shërbimit për kopshtet publike të Bashkisë Librazhd është një pjesë kritike e përpjekjeve për të siguruar një mjedis të përshtatshëm dhe cilësor për fëmijët. Këto procese janë themelore për arritjen e qëllimeve të përcaktuara, duke përfshirë trajnimin e stafit, përmirësimin e infrastrukturës së



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHË

KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I ARSIMIT, KULTURES, SPORTIT, SHENDETESISE DHE ÇESHTJEVE SOCIALE

	<p>kopshteve dhe sigurimin e materialeve didaktike. Qëllimi i proceseve mbështetëse është të ofrojnë mbështetje efektive për proceset kryesore të shërbimit në kopshte. Këto përfshijnë aspekte të rëndësishme si:</p> <ul style="list-style-type: none">- edukimi;- siguria;- zhvillimi; dhe- aksesueshmëria për të gjithë fëmijët. <p>Objektivat kryesore përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none">- plotësimin e standardeve të vendosura nga ligji për stafin e kopshteve;- rikonstrukcionin e godinave të kopshteve për të përmirësuar infrastrukturën; dhe- sigurimin e materialeve didaktike për të përmbushur nevojat e zhvillimit të fëmijëve. <p>Eshtë parashikuar trajnimi i stafit për situata emergjente dhe për përdorimin e teknologjisë së informacionit, nëpërmjet bashkëpunimit me agjencitë përkatëse për sigurimin e trajnimeve të nevojshme.</p> <p>Në planifikimin e nevojave për materiale, është parashikuar hartimi i një liste të unifikuar të materialeve didaktike për të siguruar një standard të përshtatshëm për zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve në kopshte.</p>
Situata Financiare (Impakti financiar, shtesa pakësime në buxhet)	Te gjitha kostot e planit jane llogaritur dhe pasqyrohen ne pogramin buxhetor afat-mesem (PBA) 2025-2027
Drejtoria Pergjegjese	Agjensia e Funksionimit te Patransferueshem, Sektori i Arsimit, Kultures, Rinise, Sporteve dhe Organizimit te Aktiviteteve Festive
Raportimi dhe Monitorimi	Raportimi do te realizohet çdo fund viti per zbatimin e Planit dhe paraqitet çdo fund Janari ne Keshillin Bashkiak.
Impakti Social dhe Grupet qe Preken	Plani është shtrirë në të gjitha kopshtet nën juridiksionin e Bashkisë Librazhd, me qëllim përmirësimin e shërbimit arsimor parashkollor për të gjithë fëmijët në të gjithë territorin e Bashkisë Librazhd.
Konsultimi Publik	Ky projekt vendim kërkon konsultim publik sipas nenit 17 te ligjit 139/2015, të Rregullores së Këshillit. Eshte marre vendimi i Kryesise per kalimin ne konsultim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHID

KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I ARSIMIT, KULTURËS, SPORTIT, SHËNDETËSISË DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE

	<p>publik të projektaktit. Eshtë hartuar dhe publikuar në faqen e internetit të Bashkisë Librazhd, njoftimi dhe kalendari për degjat publike. Eshtë realizuar degja me publikun (date 10 Dhjetor 2024) ku kanë marrë pjesë 32 persona, anetare të komiteteve të prindërve, prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara, organizata jo fitimprurëse, qytetare, mesuese, drejtuese të kopshteve, administrata e bashkisë, drejtuar nga keshilli bashkiak. Eshtë mbajtur procesverbali i takimit dhe kanë dalë rekomandimet e konsultimit publik të cilat janë përmbledhur dhe i janë dërguar Kryetarit të Bashkisë për reflektim.</p>
--	--


Komisioni i Përbërshëm i Arsimit, Kulturës, Sportit, Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, i mbledhur më datën 16 Dhjetor 2024 pasi shqyrtoi Projekt-vendimin për miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit të Arsimit Parashkollor, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ti propozojë Këshillit Bashkiak:
 - a. Miratimin e projektaktit


Bashkëlidhur argumentat e vendimarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e Komisionit


Kryetare e Komisionit: Fatbardha QATJA 

Nenkryetar i Komisionit: Kujtim ALBRAHIMI

Anetare e Komisionit: Flutura KOJKU 

Anetar i Komisionit: Ilir KUKA

Anetare e Komisionit: Silvana HOXHA 

Anetare e Komisionit: ARSIANA ÇEKAZI 

Anetar i Komisionit: DASHYRA HYSA 

Librazhd më: 16. 12. 2024